

Rekord udhëtarësh në
Aeroportin e Prishtinës, në
janar mbi 21 për qind më
shumë se në vitin e kaluar

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ASOCIACIONI I GAZETARËVE I KOSOVËS (AGK) DHE KËSHILLI I MEDIEVE
TË SHKRUARA I KOSOVËS (KMSHK) DËNOJNË ASHPËR QEVERINË PËR NDRYSHIMET
NË PROJEKTLIGJIN PËR KPM-në

FAQE 4-5

QEVERIA DUHET TË TËRHIQET NGA TENTATIVA PËR KONTROLL SHTETËROR TË MEDIEVE ONLINE



KOSOVË
Treguesit e nivelit
të lirisë së medias
he sigurisë së gazetarëve

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara i Kosovës (KMSHK) i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligjin që parasheh rregullimin e medieve online. I ashtuquajtur Projektligj për

Komisionin e Pavarur të Medieve është miratuar nga qeveria më 27 dhjetor të vitit të kaluar dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës. Ky hap i ekzekutivit është konsideruar përpjekje e re e qeverisë aktuale që t'i sulmojë mediet. "Projektligji duhet të shihet si

vazhdimësi e qasjes armiqësore të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ndaj medieve dhe gazetarëve dhe tentativës së saj të vazhdueshme për t'i disiplinuar ato", është thënë nga përfaqësuesit e AGK-së, KMSHK-së dhe juristes së të drejtës së medias, Flutura Kusari

34-VJETORI I LËVIZJES
SË PAJTIMIT TË GJAEVE
NË KOSOVË 1990-1991

**U FALËN
GJAEQET PËR T'U
BASHKUAR PËR
LUFTË KUNDËR
SERBISË**

F. 3



**DAUT HARADINAJ:
ME KOEFICIENTIN E RI
TË PAGËS, NGRITJEN
MË TË LARTË E KANË
PRESIDENTJA,
KRYEPARLAMENTARI,
KRYEMINISTRI
DHE KËSHILLTARËT
POLITIKË**

F. 6



**AKB-ja: MBI 200 MIJË QYTETARË
U LARGUAN NGA KOSOVA
NË PESË VITET E FUNDIT**

F. 8

**BE-ja KËRKON TRANZICION
TË GJATË PËR LARGIMIN NGA
PËRDORIMI TË DINARIT SERB**

F. 8

SPORT



**PRESIDENTI I FFK-SË TAKON
GJYQTARIN E NJOHUR TË CAS-IT,
DISKUTOJNË PËR RREGULLAVE E
TRANSFERIMIT TË LOJTARËVE**

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princsha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
030-500 878 | 045-500 878
044-500 878 | 049-500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BE-ja pajtohet për paketën e ndihmës për Ukrainën në vlerë prej 50 miliardë eurosh

BRUKSEL, 1 SHKURT - Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, tha se 27 anëtarët e bllokut evropian janë pajtuar për paketën e re të ndihmës për Ukrainën në vlerë prej 50 miliardë eurosh. Marrëveshja u arrit gjatë një samiti të udhëheqësve të Bashkimit Evropian të mbajtur në Bruksel më 1 shkurt.

Miratimi i paketës së ndihmës ishte vënë në pikëpyetje për shkak të kundërshtimeve paraprake të Hungarisë. “Kemi marrëveshje... Kjo zhblokon financimin e qëndrueshëm, afatgjatë dhe të parashikueshëm për Ukrainën. BE-ja po merr udhëheqjen dhe përgjegjësinë në mbështetje të Ukrainës. Ne e dimë se çfarë është në rrezik”, ka shkruar Michel në platformën “X”.

Një paketë e tillë e ndihmës ishte bllokuar dhjetorin e kaluar nga kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban. “Është shumë e rëndësishme që vendimi u mor nga të gjithë 27 udhëheqësit e BE-së, që edhe një herë dëshmon unitetin e fortë të BE-së”, ka shkruar në “X” presidenti ukrainas



Volodymyr Zelensky, pas publikimit të vendimit. “Ndihma e vazhdueshme financiare e BE-së ndaj Ukrainës do ta forcojë ekonominë në terma afatgjatë dhe stabilitetin financiar, të cilët nuk janë më pak të rëndësishëm se mbështetja ushtarake dhe presioni ndaj Rusisë përmes sanksioneve”, shtoi ai.

Nuk ka pasur një koment të menjëhershëm lidhur me marrëveshjen nga Orbani, i cili nuk foli për gazetarët kur hyri në samit

më herët gjatë 1 shkurtit. “Marrëveshje. Këshilli Evropian jetësoi prioritetet tona. Mbështetja e Ukrainës. Luftimi i emigrimit të paligjshëm. Një ditë e mirë për Evropën”, ka shkruar në “X” presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen.

Agjencia gjermane e lajmeve, Dpa, që ka parë një kopje të vendimit, tha se në të thuhet që liderët e BE-së “do të mbajnë një debat të përvitshëm” për zbatimin e shpërndarjes së fondeve për Ukrainën dhe “nëse

është e nevojshme, pas dy vjetësh, Këshilli Evropian do ta ftojë Komisionin Evropian të bëjë propozim për rishikim” e financimit.

Pas këtij vendimi të udhëheqësve të BE-së, Ukraina tha se pret që ta pranojë pjesën e parë të ndihmës, në vlerë prej 4.5 miliardë eurosh, gjatë muajit të ardhshëm.

Në samitin në Bruksel, nga udhëheqësit e 27 shteteve anëtare të bllokut, kërkohej që të vendosnin në mënyrë unanime për paketën e ndihmës për Ukrainën, që do të financohet nga buxheti i përbashkët i BE-së.

Orban, populist i krahut të djathtë, që është në pushtet që nga viti 2010, është përballur me kritika se kundërshtimi i tij për ndihmën e BE-së për Ukrainën përbën shantazh të bllokut për miliarda euro fonde, që BE-ja ka ngrirë për Hungarinë për shkak të shqetësimeve të Brukselit për nivelin e demokracisë dhe sundimit të ligjit në Budapest.

Para samitit, ministrat e Mbrojtjes të bllokut u takuan në një takim joformal më 31 janar në Bruksel për

të diskutuar për nevojën e forcimit të industrisë së mbrojtjes së bllokut dhe për ndihmën ushtarake për Ukrainën.

Ukraina ka nevojë urgjente për ndihmë financiare dhe ushtarake, në mes të sinjaleve për një lodhje politike të Perëndimit përderisa pushtimi rus i Ukrainës është afër dyvjetorit.

Duke shtuar shqetësimet e Kievit, një projektligj shtesë për shqetësimet që përfshin 61 miliardë dollarë ndihmë për Ukrainën është bllokuar nga Kongresi amerikan, mes kundërshtimeve të ligjvënësve republikanë. Orban, i vetmi udhëheqës i BE-së që ende ka raporte të ngushta me presidentin rus Vladimir Putin, vazhdimisht ka pasur mosmarrëveshje me udhëheqësit e tjerë të bllokut lidhur me masat për ta ndihmuar Ukrainën që nga nisja e pushtimit rus të Ukrainës në shkurt të vitit 2022.

Ai ka shprehur kundërshtime ndaj sanksioneve të BE-së ndaj Rusisë, madje ka hedhur idenë e mbajtjes së bisedimeve të paqes në mes të Moskës dhe Kievit.

Turqia thotë se ende është e interesuar të blejë avionë luftarakë evropianë

ANKARA, 1 SHKURT - Turqia është ende e interesuar të blejë 40 avionë luftarakë të llojit Eurofighter Typhoon, tha një zyrtar i Ministrisë turke të Mbrojtjes, pasi Shtetet e Bashkuara avancuan procesin e shitjes në Ankara të avionëve F-16. Avionët amerikanë F-16 pritet t'i kushtojnë Turqisë 23 miliardë dollarë.

Në nëntorin e vitit të kaluar Turqia tha se po bisedon me Britaninë dhe Spanjën për të blerë avionët Typhoon, edhe pse Gjermania kishte kundërshtuar shitjen e këtyre fluturakeve luftarake për Ankarën. Atëbotë burimet brenda Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë thanë se bisedimet kishin nisur



pasi Ankaraja e pranoi se kërkesa për blerjen e avionëve amerikanë F-16, që fillimisht ishte bërë në tetor të vitit 2021, mund të mos pranohej.

Javën e kaluar administrata e presidentit amerikan Joe Biden zyrtarisht njoftoi Kongresin për synimin që ta procedojë shitjen në Turqi të 40 avionëve F-16, të prodhuar nga Lockheed Martin, dhe komponentë të tjerë ushtarakë. Njoftimi i administratës amerikane u bë një ditë pasi Ankaraja përfundoi procesin e ratifikimit të anëtarësimit të Suedisë në NATO.

Edhe pse nuk pritet që Kongresi amerikan ta bllokojë shitjen e

avionëve F-16, Turqia ende dëshiron të blejë avionë Eurofighter Typhoon, tha një zyrtar i Ministrisë së Mbrojtjes së Turqisë, që foli në kushte anonimiteti, raporton Reuters. “Ne ende jemi të interesuar, ne presim një qasje pozitive për këtë çështje nga anëtarja e konsorciumit, Gjermania”, tha zyrtari.

Avionët Eurofighter Typhoon ndërtohen nga një konsorcium i përbërë nga Gjermania, Italia dhe Spanja, të përfaqësuar nga Airbus, BAE Systems dhe Leonardo Turqia, që po synon ta forcojë fuqinë ajrore, po ashtu është duke zhvilluar avionët e saj luftues KAN, në bashkëpunim me BAE.

Anëtarët e Kongresit: ShBA-ja duhet ta mbështesë Ballkanin Perëndimor përballë ndikimit të Rusisë dhe Kinës

UASHINGTON, 1 SHKURT - Anëtarë të Kongresit dhe zyrtarë të lartë amerikanë, si edhe anëtarë parlamentesh të vendeve evropiane dhe Ballkanit Perëndimor, shprehën të mërkurën shqetësimin për ndikimin keqdashës të Rusisë dhe Kinës në Ballkanin



Perëndimor. Ata folën për këtë temë në një forum në Kongresin amerikan. Pjesëmarrësit thanë se Rusia dhe Kina po përpiqen ta rritin ndikimin e tyre përmes ndërhyrjeve politike dhe dezinformimit në rastin e Moskës, si edhe kryesisht

përmes investimeve ekonomike dhe infrastrukturore në rastin e Pekinit. Ata theksuan nevojën e forcimit të koordinimit mes ShBA-së dhe aleatëve të tyre me vendet e Ballkanit Perëndimor. Ata, gjithashtu, folën për nevojën e integritetit të rajonit.

34-VJETORI I LËVIZJES SË PAJTIMIT TË GJAQEVE NË KOSOVË 1990-1991

EPOKA ERE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 SHKURT - Më 29 janar janë bërë 34 vjet nga vendimi i madh për të filluar pajtimin e gjaqeve, plagëve dhe ngatërresave në Kosovë. Më 2 shkurt 1990 Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve në Kosovë 1990-1991 shënon ndërhyrjen e parë në Lumbardh të Deçanit, e cila rezultoi me një besë dymuajshe. Nismëtarët e pajtimit të gjaqeve në Kosovë ishin: Myrvete Dreshaj, Have Shala, Adem Grabovci, Ibrahim Dreshaj dhe Lulëzim Etemaj. Të gjithë studentë dhe ish- të burgosur



politikë. Shtrirja e dorës së pajtimit të parë në Kosovë, e arritur nga kjo Lëvizje, pas 14 vjetësh hasmëri, është ajo në mes të Fazli Buqollit dhe Idriz Buqollit, më 10 shkurt 1990, në fshatin Raushiq të Pejës. Kontribut të fuqishëm në arritjen e këtij pajtimi ka dhënë edhe heroi Xhemajl Fetahaj. Lëvizja e Pajtimit të Gjaqeve u përhap shpejt dhe mori përmasa gjithëpopullore, ku, pas ftesës së nismëtarëve, u inkuadruan Anton Çetta dhe shumë profesorë të tjerë të UP-së. Shtrirja e pajtimit të gjaqeve mori hovë edhe në Tetovë, Shkup, Gostivar, Luginë të Preshevës etj. Me qëllim të koordinimit të veprimtarisë së saj, Lëvizja e Pajtimit

të Gjaqeve në Kosovë, gjatë periudhës njëvjeçare të funksionimit, 1990-1991, ka mbajtur tri Kuvende: Kuvendi I, 19 maj 1990 në Strellc të Deçanit, Kuvendi II, 18 nëntor 1990 në Osekë Hylë të Gjakovës, Kuvendi III, 17 maj 1992 në Prishtinë.

Tubimet masive për faljen e gjaqeve

Më 15 prill 1990 është mbajtur tubimi për faljen e gjaqeve në Novosellë të Gjakovës dhe Zllakuqan, në ditën e festës së



Pashkëve. Aty u falën 16 gjaqe, plagë dhe ngatërresa. Ndërkaq më 26 prill 1990 është mbajtur një tubim edhe në Bubaveç të Malishevës, ku u falën 37 gjaqe, shumë plagë dhe ngatërresa. Më 1 maj 1990 është

mbajtur tubimi për faljen e gjaqeve te Verrat e Llukës, ku ndodhën 106 pajtime: 62 gjaqe, 25 plagë dhe 19 ngatërresa. Në këtë tubim pajtues morën pjesë 500 000 pjesëmarrës. Më 28 korrik 1990 u mbajt edhe një

tubim për faljen e gjaqeve në Çegran, në “Rudinën e Pajtimit”, bri Malit të Thatë, ku u falën 3 gjaqe dhe 6 ngatërresa. Aty arritën të tuboheshin 50 mijë veta. Shumica e tubimeve të tilla të mëdha hapeshin me thirrjen - kushtrim të heroit Adem Demaçi: “Jo atyne që janë trima me ngrehë gishtin e krimin, por atyne që janë burra me shtri dorën e pajtimit”. Numri i pajtimeve të arritura brenda një viti, 1990-1991, të Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve, shkoj në 2 511. Prej tyre, 1 169 janë gjaqe, 477 plagë, ndërsa 865 është numri i ngatërresave. Të gjitha gjaqet, plagët dhe ngatërresat u falën nga familjet e dëmtuara pa asnjë kusht a kompensim, në emër të rinisë, të Kosovës, flamurit kombëtar dhe gjakut të dëshmorëve të derdhur për liri; në emër të të burgosurve politikë që po kalbeshin nëpër burgjet e Jugosllavisë.



Rekord udhëtarësh në Aeroportin e Prishtinës, në janar mbi 21 për qind më shumë se vitin e kaluar

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 SHKURT - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” ka njoftuar se ka përmbyllur një vit të suksesshëm me një numër udhëtarësh, asnjëherë të arritur më parë. Sipas njoftimit, në muajin nëntor 2023 përmes aeroportit ka udhëtuar një numër prej 3 milionë udhëtarësh, ndërsa në fundvit ky numër ka shkuar në 3 milionë e 424 mijë e 883 udhëtarë.

Kjo është një rritje prej 14,37-përqindësh krahasuar me vitin paraprak dhe 23 mijë e 278 fluturime apo 7.5 për qind më shumë se në vitin 2022. Numri i udhëtarëve dhe fluturimeve thuhet se po vazhdon me një trend të rritjes, ku në muajin janar 2024 janë shërbyer 287 mijë e 205 udhëtarë apo 21.9 për qind më shumë se në muajin janar 2023 dhe 996 fluturime apo 23.3 për qind më shumë krahasuar me janarin e vitit 2023. Muaji janar 2023 kishte 235 mijë e 576 udhëtarë

dhe 808 fluturime të shërbyera. “Kjo rritje e jashtëzakonshme thekson përkushtimin e aeroportit për të ofruar përvoja të reja për udhëtarët e saj duke qenë të orientuar edhe në shtimin e destinacioneve apo rritjen e fluturimeve në destinacionet ekzistuese në vitin 2024”, thuhet në komunikatën për medie. Për t’i përmbyllur kërkesat e udhëtarëve, Aeroporti i Prishtinës ka bërë me dije se këtë vit ka shtuar destinacionet e reja Luksemburg, Riga, Izmir, Heraklion, Halmstad etj.





ASOCIACIONI I GAZETARËVE I KOSOVËS (AGK) DHE KËSHILLI I MEDIEVE TË SHKRUARA I KOSOVËS (KMSHK) DËNOJNË ASHPËR QEVERINË PËR NDRYSHIMET NË PROJEKTLIGJIN PËR KPM-në

Qeveria duhet të tërhiqet nga tentativa për kontroll shtetëror të medieve online

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara i Kosovës (KMSHK) i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligjin që parasheh rregullimin e medieve online. I ashtuquajti Projektligj për Komisionin e Pavarur të Medieve është miratuar nga qeveria më 27 dhjetor të vitit të kaluar dhe është dërguar për miratim në Kuvendin e Kosovës. Ky hap i ekzekutivit është konsideruar përpjekje e re e qeverisë aktuale që t'i sulmojë mediet. "Projektligji duhet të shihet si vazhdimësi e qasjes armiqësore të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ndaj medieve dhe gazetarëve dhe tentativës së saj të vazhdueshme për t'i disiplinuar ato", është thënë nga përfaqësuesit e AGK-së, KMSHK-së dhe juristes së të drejtës së medias, Flutura Kusari

kërkesës për të pasur qasje në të. Ajo ka thënë që nëse këto ndryshime miratohen, do të ndryshojë në mënyrë radikale mënyra e rregullimit të medieve online që publikojnë video - prej vetërregullimit, në rregullim shtetëror. Sipas saj, ndryshimet i detyrojnë mediet online t'i nënshtrohen licencimit shtetëror. "Secila media online, që dëshiron të publikojë video, do të duhej të aplikonte për leje te Komisioni i Pavarur për Media, nëse projektligji miratohet", ka thënë ajo.

Komisioni i Pavarur i Medieve (KPM) - i themeluar në vitin 2005 - është organ kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit në Republikën e Kosovës. AGK-ja funksionon si shoqatë joprotitabile, ndërsa KMSHK-ja është trup vetërregullues.

Në vend të ndryshimeve, qeverisë i është kërkuar t'i fuqizojë AGK-në, KMSHK-në dhe gjykatat, që të mund ta bëjnë punën e tyre edhe më mirë.

Kusari ka thënë se nuk qëndron arsyetimi i qeverisë për ndryshimet, me qëllim të përfrimit të legjislacionit me atë të Bashkimit Evropian pasi, sipas saj, ndryshimet janë në kundërshtim me standardet e Këshillit të Evropës, ku synon të anëtarësohet Kosova.

Mes të tjerash, parashihet që KPM-ja t'i ketë 11 anëtarë, nga shtatë sa i ka aktualisht. "Iniciativa ligjore e Zyrës së Kryeministrit është iniciativë për t'i kontrolluar mediet online përmes licencimit dhe është sulmi i radhës ndaj medieve", ka vlerësuar Kusari.

Përgjatë konferencës, Kusari ka theksuar se nuk po bëhet thirrje që ligjet të mos harmonizohen

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

Prishtinë, 1 shkurt - Më 27 dhjetor 2023 Qeveria e Kosovës, e drejtuar nga Albin Kurti, ka miratuar në mbledhje Projektligjin për Komisionin e Pavarur për Medie (KPM). Projektligji është proceduar në Kuvendin e Kosovës

në janar të këtij viti.

Asociacioni i Gazetarëve i Kosovës (AGK) dhe Këshilli i Medieve të Shkruara i Kosovës (KMSHK), përmes një adresimi për medie, i kanë bërë thirrje Qeverisë së Kosovës të heqë dorë menjëherë prej ndryshimeve në projektligjin që parasheh rregullimin e medieve online.

Në një konferencë të përbashkët

për medie të përfaqësuesve të AGK-së, të KMSHK-së dhe juristes së të drejtës së medias, Flutura Kusari, u tha se ky hap i ekzekutivit është konsideruar "përpjekje e re e qeverisë aktuale që t'i sulmojë mediet".

Juristja e medieve, Flutura Kusari, ka thënë se dokumenti i miratuar nga qeveria është bërë publik në faqen e kryeministrit, vetëm pas

me ato të BE-së. Ajo ka sqaruar se kur një direktivë e BE-së zbatohet në praktikë, merren parasysh rrethanat e atij shteti, prandaj edhe ekzistojnë modele të ndryshme.

Kusari është ndalur te rasti i Finlandës, duke treguar se kur ka nisur të zbatohet direktiva e bllokut evropian, Kuvendi dhe qeveria kanë arritur pajtueshmëri që mediet online në tërësi të vetërregullohen, sepse ashtu ka funksionuar.

Ata më pas e kanë njoftuar BE-në që nuk mund të bëjnë ndryshime në atë fushë, sepse për Finlandën vetërregullimi ka qenë modeli ideal. “Ne po e kërkojmë të njëjtën”, ka thënë ajo.

Kryetari i AGK-së, Xhemajl Rexha, ka kërkuar të vazhdohet me vetërregullim të medieve dhe të merret parasysh konteksti lokal i zhvillimit të medieve.

Drejtori i KMSHK-së, Imer Mushkolaj, ka thënë se aktualisht në Kosovë ekzistojnë organizata dhe kornizë e mjaftueshme ligjore që të adresohen të gjitha shqetësimet për përmbajtjen në medie.

Organizatat prestigjioze ndërkombëtare dhe rajonale i janë bashkuar kërkesës së Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës dhe Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës drejtuar Qeverisë së Kosovës që ta tërheqë projektligjin për Komisionin e Pavarur për Medie.

Edhe sekretari i përgjithshëm i European Federation of Journalists - EFJ, Ricardo Gutierrez, ka kërkuar nga autoritetet e Kosovës dhe kryeministri Albin Kurti, që urgjentisht të tërhiqet Projektligji për Komisionin e Pavarur për Medie. “Së bashku me AGK-në, besojmë se licencimi i medieve online nga organet shtetërore nuk është asnjëherë zgjidhje. Le të punojmë së bashku për të gjetur zgjidhje që të jemi në përputhje

me standardet e Këshillit të Evropës”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Ndryshimet kryesore ligjore të propozuara sipas projektligjit të dërguar në Kuvend

“Propozimi ligjor për herë të parë në historinë e re të Kosovës ndryshon radikalisht mënyrën e rregullimit të medieve online që publikojnë video (tutje: mediet online) nga sistemi i vetërregullimit në rregullim shtetëror, duke i detyruar ato t'i nënshtrohen procedurës së licencimit shtetëror. Ndryshimet ligjore, të cilat arsyetohen në emër të përafrimit të legjislacionit vendor me atë evropian, janë në kundërshtim me standardet e Këshillit të Evropës (KiE) dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE)”, është thënë në komunikatën e përbashkët të AGK-së dhe KMSHK-së të lëshuar pas konferencës së thirrur për medie. Sipas kësaj komunikate, ndryshimet kryesore ligjore të propozuara janë: 1. Mediet online do t'i nënshtrohen licencimit shtetëror dhe kontrollit nga KPM-ja; 2. Mediet online, të cilat funksionojnë si organizata joqeveritare, do të detyrohen që të hapin kompani për t'i plotësuar kërkesat e licencimit; 3. Mediet online do të detyrohen të regjistrohen në Regjistrin e medieve online, i cili do të menaxhohet nga KPM-ja; 4. Mediet online do të duhet të marrin leje në KPM në rast të ndryshimit të pronësisë mbi 10%; 5. Mediet online do t'i nënshtrohen regjimit të sanksioneve me gjoba deri në 40,000 euro; 6. KPM-ja do t'i ketë 11 anëtarë dhe jo shtatë, siç i ka aktualisht; 7. Anëtarët e KPM-së nuk do të kenë më mandate të

përshkallëzuara prej dy, tre dhe katër vjetësh, por mandat prej katër vjetësh me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat tjetër. “Ne konsiderojmë se iniciativa ligjore e Zyrës së Kryeministrit për të kontrolluar mediat online nëpërmjet licensimit është sulmi i radhës ndaj të drejtës së lirisë së medias dhe pluralizmit. Aparati shtetëror do të përdoret lehtësisht kundër secilit medium online nën kërcënimin e gjobave të mëdha deri në 40,000 mijë euro, gjobë kjo që mund të arrijë të mbyllë secilin medium online që operon në Kosovë. Projektligji duhet të shihet si vazhdimësi e qasjes armiqësore të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, ndaj medieve dhe gazetarëve dhe tentativës së saj të vazhdueshme për t'i disiplinuar ato”, është thënë në komunikatën e AGK-së dhe KMSHK-së.

Më tej është theksuar se direktiva e rishikuar e Shërbimeve të Medias Audiovizuale (AVMS) me të cilën pritet të përafrohet legjislacioni për media në Kosovë, parashihet rregullimin e platformave për shpërndarjen e videove nga rregullatorët e medieve. “Mirëpo, për qëllime të kësaj iniciative ligjore direktiva është interpretuar gabimisht, pa e marrë fare parasysh kontekstin lokal dhe duke injoruar trupin vetërregullativ ekzistues në Kosovë. Direktiva në asnjë formë nuk parashihet që shteti t'i vë mediet online nën kontroll nëpërmjet procesit të licencimit të detyrueshëm. Në fakt, Direktiva e BE-së në nenin 4A inkurajon shtetet që ta përdorin sistemin e vetërregullimit. Për këtë arsye, në Finlandë gjatë transpozimit të AVMS-së, qeveria dhe parlamenti atje, pasi kishin marrë për bazë kontekstin lokal dhe duke u bazuar në nenin 4A të direktivës, ishin dakorduar që këtë kompetencë të vazhdonin t'ia

linin këshillit të mediave (trupit vetërregullativ finlandez). Në Shqipëri, Këshilli i Europës dhe Komisioni i Venecias kishin kundërshtuar fuqishëm propozimet e njëjta ligjore që ishin bërë nga qeveria shqiptare e udhëhequr nga z. Edi Rama. Ndërsa Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) kërkon në mënyrë të qartë që regjistrimi i mediave online assesi të mos jetë procedurë e detyrueshme”, thuhet në këtë komunikatë.

Sipas AGK-së dhe KMSHK-së, një pasojë tjetër do të jetë dobësimi i Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK) që përbëhet nga përfaqësues të medieve, përderisa do të fuqizohet një organ administrativ shtetëror si KPM-ja, anëtarët e të cilit zgjedhen nga partia në pushtet. “Historikisht KPM-ja - me disa përjashtime - është përbërë nga persona që kanë vepruar dhe vazhdojnë të veprojnë me udhëzime direkte ose indirekte nga politika apo sektori privat. Qeveria, përtej mediave, tentativën për kontroll e ka shtrirë edhe tek vetë institucioni i KPM-së. Rritja e numrit të anëtarëve në 11 është e paarsyeshme dhe bazohet vetëm në dëshirën e partisë në pushtet që ky institucion të mbushet më mbështetës të saj. Kjo konfirmohet edhe me propozimin që secili anëtar të ketë mundësinë që të garojë për dy mandate, ashtu që ata që emërohen gjatë kësaj legjislature në Kuvend dhe vazhdojnë ta gëzojnë mbështetjen e partive në pushtet edhe në një tjetër legjislaturë, pra, mund të jenë pjesë e KPM-së për tetë vjet gjithsej. Ne, po ashtu, shprehim indinjatën tonë me nivelin e lartë të mostransparencës gjatë kësaj iniciative legjislative. Draftligji është përgatitur me mungesë të thellë të transparencës dhe pa

përfshirjen e gazetarëve, mediave, aktivistëve dhe organizatave tjera të shoqërisë civile. Vetëm pas përfundimit të draftit të parë, ai është prezantuar para një grupi të kufizuar si akt i kryer. Kjo qasje është tërësisht jodemokratike, e papranueshme dhe zhgënjyese. Nuk mund të draftohet legjislacion për media pa përfshirjen e mirëfilltë të sektorit të medieve”, thuhet, ndër të tjera, në komunikatën e AGK-së dhe KMSHK-së.

Këto dy institucioneve të medieve kanë theksuar se i kanë ofruar Zyrës së Kryeministrit dialog dhe mundësi bashkëpunimi për ta përmirësuar draftligjin. “Një vit më parë, në një takim me shefin e stafit të kryeministrit z. Luan Dalipi dhe këshilltaren ligjore të kryeministrit znj. Tea Blakaj, ata na kishin siguruar që projektligji nuk do të procedohej në atë mënyrë në Kuvend. Më pastaj ata kishin injoruar në tërësi kërkesat tona rreth informacioneve për projektligj. Ndryshimet ligjore - të bëra në formën siç janë tani - nuk do rezultojnë në përmirësimin e mediave, por në kontroll politik mbi mediat online, kontroll që do të ushtrohet nga cilado parti politike që do të gëzojë pushtet. Ne kërkojmë nga Zyra e Kryeministrit të tërheqë projektligjin nga Kuvendi i Kosovës dhe të bëjë ndryshimet e duhura në pajtim me standardet e KiE dhe OSBE-së. Ndryshimet ligjore duhet të bëhen me përfshirje të mirëfilltë të gazetarëve, organizatave joqeveritare dhe të gjithë të interesuarve. Njëkohësisht, shteti duhet të angazhohet për pavarësinë e plotë të KPM-së duke zgjedhur profesionistë të pavarur, e jo simpatizues të partisë në pushtet”, ka përfunduar komunikata e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK-së) dhe Këshillit të Medieve të Shkruara të Kosovës (KMSHK-së).



PDK-ja në Prishtinë kërkon që zona e Badovcit të ruhet nga ndërtimet dhe këmbimet

PRISHTINË, 31 JANAR - Dega e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë ka kërkuar që zona e Badovcit të ruhet nga ndërtimet dhe këmbimet. Kryetari i Grupit të Asamblistëve të PDK-së në Prishtinë, Leutrim Retkoceri, në një konferencë për medie tha se as të mërkurën grupi i asamblistëve i PDK-së nuk mori pjesë në mbledhjen e ftuar të Kuvendit Komunal të Prishtinës, sepse është muaji i dytë që ky Kuvend është shndërruar në fushëbetejë pronash. “Derisa në mbledhjen e dhjetorit u votua këmbimi i pronave që kanë në epiqendër Badovcin, me kuorumin e

mundësuar nga opozita në krye me LV-në, sot nga vetë këta të fundit u iniciua anulimi i të njëjtit vendim. Ne e kemi ditur që çështja e Badovcit do të rikthehet në diskurs publik në këtë qeverisje. Më 2020 kemi votuar kundër, në fushatë kemi deklaruar kundër, dhe vazhdojmë të mos e përkrahim: Zona e Badovcit duhet të ruhet nga ndërtimet dhe këmbimet me çdo kusht, edhe nëse kjo nënkupton që ne, PDK-ja në Prishtinë, si pjesë e koalicionit qeverisës, nuk e mbështesim në Kuvend”, ka theksuar Retkoceri. Ai ka thënë se përpjekja e sotme për të anuluar një vendim, të cilin vetë LV-ja e ka mundësuar,



është përpjekje e shfaqjesimit nga një e keqe publike. “Partneri i koalicionit, në krye me kryetarin Rama, beson që vendimi është i

duhur. Të njëjtën, me të drejtën e tij, e ka paraqitur edhe në një konferencë për medie. Ky vendim mori mbështetje në

Kuvend nga shumica e asamblistëve në mbledhje, por u mundësua vetëm sepse LV-ja çuditërisht vendosi të qëndrojë në sallë. Këtë njëherë e arsyetoi se duhet ta bënte sepse është në vend pune, kur ne e dimë që ka shumë mbledhje të kaluara ku LV-ja nuk ka qëndruar në sallë. Më vonë edhe deklaruan se ‘atyre pronarëve, komuna iu ka borxh tokë dhe kjo, sipas tyre, është e pakontestueshme”, ka deklaruar Retkoceri. Ai ka thënë se ajo çfarë duhet të theksohet është se ky vendim nuk është me vetëm një vendim i votuar një ditë pune në Kuvendin Komunal të Prishtinës, por tashmë është në gjykatë.

Kurti përkujtoi dëshmoren e lirisë, Elfete Humolli, në 34-vjetorin e rënies

PODUJEVË, 1 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, bëri të enjten homazhe në nderim të jetës dhe veprës së dëshmores së kombit, Elfete Humollit, me rastin e shënimit të 34-vjetorit të rënies së saj. Vetëm dy javë nga ditëlindja e saj Elfete Humolli, ende pa i mbushur 17 vjet, ra dëshmore e lirisë, e vrarë nga forcat armike serbe, në drejtim të demonstruesve që ishin bashkë me Elfeten duke demonstruar për lirinë e Kosovës, për çlirimin e vendit. I ndodhur pranë lapidarit të të dy dëshmorëve të kombit, Elfetes dhe vëllait të saj, Mentorit, në Kompleksin Memorial në Lupç të Poshtëm, kryeministri Kurti në



përkujtim të të gjithë heronjve e dëshmorëve të kombit tha se

“Elfetja, Mentori dhe të gjithë dëshmorët e kombit, na e

dëshmojnë orët e historisë sonë, na e dëshmojnë se sa shtrenjtë është paguar liria e popullit dhe çlirimi i Kosovës”. Ai veçoi se sot në këto homazhe janë bashkë me nxënësit që kanë moshën e Elfetes kur ajo kishte rënë në demonstratë. Nxënës që sot mësojnë në Kosovën e lirë, në vendin tonë gjithnjë e më të përparuar dhe të cilët do t'i kontribuojnë shoqërisë, kombit dhe shtetit si dhe ekonomisë, kulturës dhe fushave të tjera të jetës. “Pra, Kosova sot i gëzohet rinisë dhe fëmijëve të saj, pikërisht për shkak se në themelet e kësaj Kosove ndodhet si gjaku i dëshmorëve, ashtu edhe djersa e punëtorëve nga e kaluara të cilët

ne i çmojmë, shprehim mirënjohjen e thellë dhe me besnikërinë ndaj tyre ecim drejt së ardhmes së ndritshme” u shpreh kryeministri Kurti. Pas homazheve te varri i heroinës Humolli, kryeministri Kurti nderoi edhe vëllanë e saj dëshmor, Mentorin, i cili u vra më 21 maj të vitit 1999, dhe këtë vit do të shënohet 25-vjetori i rënies si luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë këtyre homazheve kryeministri Kurti ishte bashkë me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, kolegë nga qeveria, deputetë të Kuvendit, veprimtarë të çështjes kombëtare dhe familjen e gjerë Humolli.

Daut Haradinaj: Me koeficientin e ri të pagës, ngritjen më të lartë e kanë presidentja, kryeparlamentari, kryeministri dhe këshilltarët politikë



PRISHTINË, 1 SHKURT - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, zyrtari i lartë i AAK-së, Daut Haradinaj, ka theksuar se me koeficientin e ri të pagës 110, ngritjen më të lartë e kanë pozitat e larta politike duke filluar nga presidentja e vendit, kryetari i Kuvendit, kryeministri etj. Sipas Haradinajt, ngritje të lartë kanë edhe këshilltarët politikë.

Ai ka thënë se me këtë koeficient dhe me këtë ngritje pagash nuk do të bëhet zgjidhja e nevojshme e cila do ta zbuste krizën ekonomike të familjeve tona. “Dje u ekzekutuan pagat në sektorin publik. Mjafton të bëhet një analizë e thjeshtë që të evidentohet impakti minimal që ka pasur ngritja e koeficientit nga 105 në 110 euro. - Një rreshter i Policisë së Kosovës, i

është rritur paga për 32 euro; - Policët të thjeshtë 25 euro; - Mësimdhënësit 29 euro; Në administratë: - Drejtorit të Departamentit 41 euro; - Udhëheqësit të divizionit 31 euro. Ndërsa zyrtarëve që në numër janë shumë, d.m.th 80% e administratës, rreth 20 euro, ushtarit 28 euro. Ngritjen më të lartë e kanë pozitat e larta politike duke filluar nga

presidentja e vendit, kryetari i Kuvendit, kryeministri etj. Po ashtu, ngritje të lartë kanë edhe këshilltarët politikë. Pra, me këtë koeficient dhe me këtë ngritje pagash, nuk do të bëhet zgjidhja e nevojshme e cila do të zbuste krizën ekonomike të familjeve tona dhe kështu nuk do ta ndalë trendin e ikjes së profesionistëve nga vendi!”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.

Gërvalla në Bundestagun gjerman flet për veprimet destabilizuese të Serbisë

BERLIN, 1 SHKURT - Situata e sigurisë në Kosovë dhe kërcënimet e vazhdueshme të Serbisë kundër paqes dhe sigurisë në rajon ishin temat kyçe të takimit që zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, pati me kryetaren e Komisionit për Mbrotjtje të Gjermanisë, Marie-

Agnes Strack-Zimmermann dhe anëtarë të këtij komisioni. Gjatë kësaj bisede të zhvilluar në Bundestagun gjerman me kryetaren dhe anëtarët e Komisionit për Mbrotjtje u diskutua edhe për bashkëpunimin ndërshtetëror në fushën e sigurisë, nevojën e ndërmarrjes së sanksioneve ndaj Serbisë për veprimet destabilizuese të saj në

Ballkanin Perëndimor, në njërën anë dhe, në anën tjetër, vazhdimin e mbështetjes së Kosovës në ngritjen profesionale, logjistike dhe anëtarësim në NATO. Ministrja Gërvalla në fund të takimit i falënderoi deputetët gjermanë për mbështetjen e tyre për Kosovën dhe nevojën e domosdoshme të ruajtjes së stabilitetit në rajon.



Bislimi i bën thirrje BE-së të jetë forcë shtytëse për Ballkanin Perëndimor

PRISHTINË, 1 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Besnik Bislimi, i ka bërë thirrje Bashkimit Evropian të jetë forcë shtytëse për Ballkanin Perëndimor, duke kërkuar që vendet evropiane të jenë unike si në rastin e Ukrainës. Pas vendimit të BE-së që t’ia japë Ukrainës një pako ndihme prej 50 miliardë eurosh, Bislimi ka thënë të enjten se sigurimi i financave për Planin e Rritjes të

Ballkanit Perëndimor është hap i madh drejt integritimit. “Vendimi i sotëm i BE-së tregon rëndësinë e unitetit dhe bashkimit. Të njëjtat parime morale që duhet të jenë forcë lëvizëse edhe për Ballkanin Perëndimor. Në këtë kuptim, sigurimi i financave për Planin e Rritjes së Ballkanit Perëndimor është hap i madh drejt integritimit”, ka shkruar Bislimi në rrjetin social “X”. BE-ja tha se marrëveshja për

ndarjen e pakos për Ukrainën “mbyll një financim të qëndrueshëm, afatgjatë dhe të parashikueshëm për Ukrainën”. Kosova është sanksionuar nga Bashkimi Evropian me disa “masa të përkohshme”. Zyrtarët e BE-së patën thënë se sanksionet janë vendosur për shkak të mospërfilljes së kërkesave për hapa të menjëhershëm nga Qeveria e Kosovës për uljen e tensioneve në veri.



Mbyllet objekti ‘misterioz’ ngjitur me Stacionin e Policisë në Prishtinë, intervistohen dy të dyshuar

PRISHTINË, 1 SHKURT - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka reaguar lidhur me bastisjen e realizuar më 31.01.2024, pas pranimit të informatës nga Ministria e Punëve të Brendshme, se në objektin - aneks i Stacionit Policor Qendra në Prishtinë është duke operuar një OJQ në mënyrë të kundërligjshme. Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, së bashku me prokurorin e rastit nga Departamenti i Krimeve të Rënda - Njësi për Krime Ekonomike dhe Korrupsion - kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme hetimore në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Drejtoria për Hetime Rajonale në Prishtinë dhe në bashkëpunim me Doganën e

Kosovës e Inspektoratit Shëndetësor, është kryer bastisje në lokalin e lartcekur, me ç’rast është konstatuar se në këtë objekt janë duke u ofruar shërbime mjekësore në mënyrë të kundërligjshme, si dhe janë intervistuar dy persona në cilësinë e të dyshuarve dhe disa të tjerë në cilësinë e dëshmitarëve. “Pas intervistimit të të dyshuarve, ata janë liruar në procedurë të rregullt, derisa është hapur rast penal në drejtim të veprës penale ‘Ushtrim i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore ose farmaceutike’, sipas KPRK-së. Gjithashtu, ju njoftojmë se nga bastisja e realizuar, me urdhër të Prokurorit të Shtetit, janë sekuestruar prova materiale të cilat do të shërbejnë në procedurën penale, ndërsa me vendim të Inspektoratit



Shëndetësor është mbyllur dije në komunikatën e Themelore në Prishtinë dhe objekti në fjalë”, është bërë me përbashkët të Prokurorisë Policia e Kosovës.

“Termokos”-i bëhet institucioni i parë që finalizon planin e dekarbonizimit për periudhën 2024-2035



PRISHTINË, 1 SHKURT - Ngrohtorja e qytetit “Termokos” është bërë institucioni i parë i cili do ta finalizojë planin e dekarbonizimit për periudhën afatmesme 2024-2035 dhe periudhën afatgjatë 2035-2050, ka bërë me dije kryeshefi Fisnik Osmani. Ai ka theksuar se plani i dekarbonizimit është dokument strategjik për N. P. “Termokos” sh.a i cili mundëson transformimin e ngrohtores së qytetit në ngrohtore karbon-neutral deri në vitin 2050. “Ulja e emitimit të gazrave sere si rezultat i ofritit të shërbimeve të ngrohjes si dhe përfshirja e BRE-ve përmes diversifikimit të burimeve të

energjisë në periudhën 2035-2050 do të jetë fokusi kryesor i ‘Termokos’-it në planin afatgjatë. Në planin afatmesëm ‘Termokos’-i do ta realizojë projektin solar4Kosovo dhe dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit për të përfshirë sa më shumë lagje të Prishtinës me shërbime të ngrohjes nga ‘Termokos’-i, në të njëjtën kohë duke përgatitur projekte konkrete investive në drejtim të dekarbonizimit të sistemit të ngrohjes. Kjo është një pjesë e përpjekjeve për t’i luftuar ndryshimet klimatike dhe për ta përmirësuar cilësinë e ajrit në qytetin e Prishtinës. ‘Termokos’-i po i jep kuptim Prishtinës së gjelbër!”, ka thënë Osmani.

UP-ja vazhdon ta përmirësojë renditjen në klasifikimin e universiteteve

PRISHTINË, 1 SHKURT - Universiteti i Prishtinës vazhdon ta përmirësojë renditjen në klasifikimin e universiteteve sipas sistemit

të radhitjes Webometrics. Në listën e përditësuar të janarit 2024, UP-ja është ngritur për 12 pozita, duke u renditur në vendin e 2884-t.

UP vijon të konsolidohet edhe në klasifikimin evropian, duke e përforcuar pozitën në mesin e 1 000 universiteteve më të mira.

Renditja e UP-së është reflektim i përparimit në kontributin shkencor të stafit akademik dhe ndikimit të tij.



Drejtuesit e ATK-së dhe OEK-ut diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 1 SHKURT - Në një takim të përbashkët, drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka prituri në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, me të cilin kanë diskutuar për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre. Tema kryesore të takimit ishin ndryshimet në Ligjin për Administrimin e Procedurave

Tatimore dhe impakti i tij te bizneset. Murtezaj e ka njoftuar Rafunën për ndryshimet e bëra në këtë ligj, se do t'i vënë theks të veçantë transparencës dhe informimit të bizneseve në kohë reale. Në kuadër të bashkëpunimit u vlerësua rëndësia e komunikimit efektiv dhe të përbashkët me komunitetin biznesor.

Administrata Tatimore dhe Oda Ekonomike kanë një synim të përbashkët për të siguruar se bizneset do të informohen në mënyrë të saktë dhe në kohë për çdo ndryshim në ligjin tatimor. U tha se ky takim shënon një hap tjetër pozitiv drejt thellimit të dialogut dhe bashkëpunimit në mes të institucioneve shtetërore dhe biznesit në Kosovë.



KDI-ja: Sinjalizuesit duhet të mbrohen, jo të persekutohen

PRISHTINË, 1 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka njoftuar se po përcjell me shqetësim zhvillimet e fundit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT). “Përmes medieve është kuptuar se sinjalizuesi publik Ernal Kutillovci, i përfshirë në zbulimin e skandalit lidhur me rezervat shtetërore, është përballur me masa disiplinore - largim nga puna, me arsyetimin se ka shkelur detyrat dhe përgjegjësit brenda institucionit. Kutillovci, duke shërbyer si zyrtar përgjegjës për cilësinë e naftës dhe produkteve të naftës në Departamentin e Rezervave Shtetërore në MINT ka treguar se në vazhdimësi ka raportuar tek eprorët e tij, përfshirë edhe ministren në detyrë, mbi shkeljet dhe parregullsitë sa i përket furnizimit me rezerva shtetërore”, është thënë në reagimin e KDI-së.



Më tej është thënë se duke marrë për bazë interesin e lartë publik në lidhje me rastin e keqpërdorimeve me rezerva shtetërore për të cilat janë duke u zhvilluar hetime nga

organet përkatëse, është thelbësore që MINT të demonstrojë se vendimi për shkarkimin e Kutillovcit është i bazuar vetëm në shkelje

disiplinore dhe nuk vjen si një përgjigje ndëshkuese ndaj aktivitetit të tij si sinjalizues. “KDI bënë thirrje që masat e tilla ndëshkuese të mos shqiptohen

nga institucionet ndaj punonjësve që sinjalizojnë mbi keqpërdorimet dhe parregullsitë në vendin e punës, e aq më pak kur të njëjtit raportojnë mbi çështje që prekin interesin publik. Sinjalizuesit në Kosovë kanë mbrojtje të garantuar me ligji nga çdo veprim i dëmshëm që vjen si pasojë e sinjalizimit. Analiza e fundit e KDI-së e publikuar në dhjetor të 2023, ‘(Mos)zbatimi i ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin ekzekutiv’ shpërfaqë që institucionet e qeverisë në përgjithësi nuk ofrojnë infrastrukturë fizike të përshtatshme që do të inkurajonte punëtorët e sektorit publik të sinjalizonjë mbi keqpërjet. Kjo ka qenë një ndër shkaqet kryesore që rastet e sinjalizimit të brendshëm nëpër disa ministri të jenë minimale ose inekzistente”, është thënë në reagimin e KDI-së.

BE-ja kërkon tranzicion të gjatë për largimin nga përdorimi të dinarit serb



PRISHTINË, 1 SHKURT - Bashkimi Evropian i ka bërë thirrje Kosovës të ofrojë periudhë të gjatë tranzicioni për largimin nga përdorimi të dinarit serb, pasi më 1 shkurt hyri në fuqi një rregullore që parasheh vetëm përdorimin e valutës euro për pagesa në Kosovë. “Bashkimi Evropian i kushton vëmendje rregullores së Bankës Qendrore të Kosovës, e cila pritët të hyjë në fuqi sot. Rregullorja synon të rrisë transparencën e flukseve financiare, të sigurojë stabilitetin

financiar dhe të luftojë pastrimin dhe falsifikimin e parave. BE-ja vëren se rregullorja do të ndikojë edhe në mbështetjen financiare që serbët e Kosovës marrin nga Serbia. BE-ja është e shqetësuar për pasojat që ky vendim mund të ketë në jetën e përditshme të serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera në mbarë Kosovën për shkak të mungesës së konsultimeve paraprake, veçanërisht për ndikimin e tij në shkollat dhe spitale, duke pasur parasysh mungesën e dukshme të

alternativave në këtë moment. Periudha e shkurtër e tranzicionit për zbatimin e rregullores, e kombinuar me mungesën e informacionit dhe zgjidhjeve praktike për të gjitha komunitetet e prekura, rrezikojnë të ndërlikojnë seriozisht jetën e tyre. BE-ja i kërkon Kosovës që të sigurojë një periudhë mjaft të gjatë tranzicioni dhe të gjejë një zgjidhje të negociuar për këtë çështje në kuadër të Dialogut të lehtësuar nga BE-ja”, është thënë në deklaratën e BE-së.

AKB-ja: Mbi 200 mijë qytetarë u larguan nga Kosova në pesë vitet e fundit


PRISHTINË, 1 SHKURT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka njoftuar se mbi 1 milion qytetarë të Kosovës jetojnë jashtë vendit. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, ka thënë se migrimi i qytetarëve të Kosovës ka qenë i vazhdueshëm që nga vitet '70 por, sipas tij, shumica kanë ikur në vitet 1990-2000. “Mesatarisht ikën mbi 450 mijë. Atëherë ishte represioni

jugosllav dhe kishte plot arsye të iknin nga Kosova. Por një studim i AKB-së nxjerr një të keqe tjetër të madhe. Vetëm në pesë vitet e fundit ikën nga Kosova mbi 200 mijë qytetarë për të kërkuar jetë më të mirë e standard jetësor, shkollim dhe siguri shëndetësore”, ka theksuar Shahini. Kryetari i AKB-së ka thënë se trendi i ikjes nga Kosova

tashmë është i njëjtë sikurse para luftës. “Përveç motiveve që ndryshojnë, atëherë ishin të frikës nga qeveria serbo-jugosllave, sot që qytetarët janë të zhgënjyer nga Qeveria e Kosovës që nuk po ndryshon asgjë në të mirë të rritjes së motivit për të gjetur një mundësi sado të vogël për të jetuar në Kosovë”, ka thënë Shahini.



Adem kreshniku



Berat ARMAGEDONI

Adem Gashit i pati rënë hise të vinte në këtë botë, në Drenicë, në vitin 1953. Sapo lindi trashëgoi emrin e Ademit të parë, të vëllait, të mbytur nga rrufeja. Pak muaj pasi i bëri shtatëdhjetë vjet, Ademi i dytë, pa bërë kurrë ankesë shëndetësore, pa bërë kurrë lëngata, u nis shtegut diellor të të lavdishmëve si rrufeja. La bujë të madhe pas vetes. La vepra letrare, la mirësi, la edukim, la tekste të këngëve. La edhe punë të pabëra. Edhe sa ishte mes nesh, edhe sot që s'është, edhe na ka mësuar për shumë gjëra, edhe vazhdon të na mësojë. Kur, në raste të tilla, në orë përkujtimore dhe në përrurime librash bashkë merrnim pjesë, mua dhe miqve të vet na thoshte: shkruani më së shumti dy faqe. E treta bëhet monotone bre! Para publikut dilni me faqe të bardhë me shkronja të zeza, se llafe mund të bëjmë ditë e natë në kafe. Modestinë e njerëzve e çmonte, vlerat e veprave të tyre i argumentonte privatisht dhe publikisht. As polemikave nuk u përtonte. I mprehtë dhe i rreptë, fort. Reagimet, për çfarëdo dukurish të këqija, nëse s'i bënte i pari, nuk i bënte i fundit. Rebel edhe pas pensionimit. I respektuar dhe i nderuar edhe pas vdekjes. Kreshnik, gjallë dhe pas vdekjes, jo

për tiparet fizike, por për tiparet morale dhe atdhetare.

Adem Gashi, para se të shkruante për veprat që kishte lexuar ndër vite dhe për dorëshkrimet e shumë autorëve, ka filluar të shkruajë dhe të botojë poezi në shtypin javor. Nxitur për t'u bërë poet e ka mësuesi i tij i filllores, Habib Çelaj, ndjesë pastël, të cilit Ademi atëkohë, sa ishte nxënës i tij, ia lexonte poezitë dhe përpiquej ta imitonte mësuesin e vet. Por, pas shumë viteve karrierë letrare, Ademi i redaktonte librat me poezi të mësuesit të vet. E para se t'ia sillte ai librat për redaktim, Adem Gashi qe bërë emër i njohur në Prishtinë, në Pejë, në Gjakovë, në Prizren, në gjithë Kosovën, edhe në disa qytete dhe shtete të ndryshme të Evropës në të cilat organizoheshin takime letrare e në të cilat, nëse nuk ftohej Ademi ose nuk kishte mundësi të shkonte, lexoheshin krijime artistike të tij edhe të përkthyer.

Shtegtimin poetik, me libër të botuar, Adem Gashi e pati nisur në vitin 1982, me titullin "Pa ombrellë". S'i duhej mbrojtja as nga shiu, as nga bora, as nga era, as nga zjarri, as nga kritikët. Nga askush. Tri vjet pas '82-s filloi ta punojë autoportretin, kurse pesë vjet më vonë realitetin objektiv. Derisa i shkruante vargjet e këtyre dy librave, shkruante edhe në përmbledhjen me tregime "Vdekja e mixhës". Ëndrrat e liga, në kohë të vështira, i vinin e i shkonin. Ëndrrat, fatkeqësisht, kishte raste që i bëheshin realitet. Në luftë iu dogjën mbi pesë mijë libra dhe disa dorëshkrime. Pas luftës, duke i kujtuar dorëshkrimet e veta, e botoi librin me poezi

"Dorëshkrim i djegur", i cili titull, për shumë poetë të Kosovës, u bë lajtmotiv në shumë poezi të tyre. Me duar në makinë të shkrimit shkroi edhe për lulet e vetmuara. Edhe pse brenda shpirtit dhe mendjes së vet kishte gjurmë të luftës, brenda familjes së gruas edhe viktima, e ndiente se duhej të shkruante edhe për dashurinë. E nisi triptikun për Ledin dhe e bitisi me shumë sakrifica dhe net pa gjumë. Ndërkohë, veprimtarisë së vet letrare ia shtoi 20 vepra me poezi, katra me tregime, dy romane, dy me eseistikë. Veprat dhe poezitë i pajisi me mbi 50 mirënjohje, çmime dhe certifikata, kurse karrierën letrare me çmimin për vepër jetësore nga Ministria e Kulturës në vitin 2022.

U patëm marrë vesh, sa ishte gjallë dhe pasi e mori këtë çmim, që libër të ri më nuk do të botoj derisa t'ia botoj kompletin e veprës në gjashtë vëllime. E priste edhe këtë botim. Po përkrah tij priste një botim të veçantë, për të cilin, në javët e fundit, më shumë kemi biseduar për të sesa për çdo temë tjetër në restorantin "Edi 2" këtu në Prishtinë. Priste botimin e përmbledhjes së teksteve të këngëve "Sërish vjen marsi" të cilat i ka shkruar për heronj, për dëshmorë, për veprimtarë shqiptarë. Kam qenë i pranishëm me të disa herë kur merrte porosi për tekste të këngëve. Në një letër të vogël, shpeshherë në kupon fiskal, me laps i shkruante të dhënat e subjektit të këngës për të cilin i rrëfenin qoftë familjarët e tij, qoftë miqtë e tij. I mjaftonin emri, mbiemri, tiparet fizike të tij, të bëmat e tij me dy-tri fjalë. Ashtu si poezitë, edhe tekstet e këngëve i

shkruante në orët e vona të natës ose në orët e para të mëngjesit. Nuk shkruante kur nuk i vinte frymëzimi. E provonte, nuk i shkonte, e linte. Po e pres dakikun, – thoshte. E provonte pas një a dy netësh. Veç një vjegëz, një fill i duhej, që një vepër atdhetare të një heroi në fushëbetejë, ta bënte kryevepër në tekst. E kryevepra të tilla, që do të përmenden e të këndohen gjithmonë, ka shkruar rreth 200. Nami dhe nishani i tij, përpos në letërsi, do të jenë të përgjithmonshëm edhe në muzikë përkrah Ilir Shaqirit.

Kaq më thoshte Adem Gashi shkruaj, se më tepër bëhet monotone për publikun.

Këtë herë po bëj një përjashtim meqë dua t'i zë ngoje edhe disa copa të biografisë së tij.


Shkollimin fillor e nisi në Nekoc, e përfundoi në Komoran. Shkollën Normale e kreu në Prishtinë. Studimet për Letërsi dhe Gjuhë Shqipe, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Prishtinës. Studimet pasuniversitare i ndërpreu për shkak të burgosjes. Pak vite punoi mësues, trembëdhjetë vjet në Radiotelevizionin e Prishtinës. Disa vjet edhe drejtori i tij. Pas luftës u emërua nënkryetar, pastaj kryetar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, e cila, meqë nuk ka ndërgjegje as sit, një telegram ngushëllimi për të s'e shkroi. Me bursë nga fondacioni gjerman "Heinrich Böll-Stiftung" ka ndenjur dhe shkruar në shtëpinë e nobelistit Bëll në Gjermani (Langenbroich). Për shkak të këshillave në interes të kulturës, më 2002 emërohet këshilltar i lartë politik i një ish-ministri të Kulturës. Me idenë dhe kërkesën e tij, MKRS-

ja nis shpalljen e konkursit për botim të librave e cila vazhdon edhe sot. Pasi ndërpret punën në MKRS, emërohet drejtor i Zyrës për Komunikim në Ministrinë e Tregtisë dhe të Industrisë, në të cilën pensionohet.

Adem Gashi, ai burrë i pjekur që iku nga ne pa na përshëndetur, u ka ndihmuar shumë krijuesve të rinj. Kudo që ka gjetur një vepër të mirë ua ka përmendur njëqind të tjerëve. Kudo që ka lexuar një poezi të mirë ia ka përmendur sekujt. Pos të rinjve, si asnjë krijues tjetër bashkëkohanik me të, ka shkruar recensionet për veprat e kolegëve të vet. Nuk ka pasur inat ndaj askujt që krijon vlera letrare. Mërzi e ka pasur të pavlerën. Nëse s'e ka grisur, e ka lënë mënjanë. Për shkak, mbase të nivelit më të lartë artistik që e kishte vetë e që s'e kishin bashkëmoshatarët e tij, ata nuk bënin kritika anasjelltas për veprat e tij. Disa prej tyre shpirtngushtësinë e shpërfaqnin me heshtje. Por, për veprat dhe krijimtarinë e Adem Gashit nuk kanë heshtur dhjetëra studiues dhe shkrimtarë të moshave të ndryshme, disa prej të cilëve i përmendi Izeti e disa prej të cilëve Ademi u ka redaktuar libra. Dhe Ai që iku e ne u mblodhëm për ta përkujtuar sot, ka redaktuar qindra libra. Ka qenë "argat" në të mbjellat e të korrat e sukseseve të shumë krijuesve. Ka derdhur djersë në shumë "ara" letrare dhe shkencore të krijuesve dhe të studiuesve. Kurrë mos u harroftë as ky mund i tij! Kaq. Lavdi!

Autori i këtij teksti, përpos mik i tij, ka qenë edhe botues i veprave të tij në vitet e fundit.





Presidenti i FFK-së takon gjyqtarin e njohur të CAS-it, diskutojnë për rregullat e transferimit të lojtarëve



PRISHTINE, 1 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, po qëndron në Tokio në kuadër të Konferencës së FIFA-s, e ku po merr pjesë në seksione të ndara të punimeve të kësaj konference, me theks të veçantë është duke ndjekur punimet ku po trajtohet tema e kalimit të lojtarëve nga klubi në klub në nivelin vendor dhe ndërkombëtar në kuadër të FIFA Clearing House. Ky program i ri i FIFA-s ofron mundësinë e gjetjes së rrugës më të lehtë dhe më profitabile të klubeve dhe futbollistëve të Kosovës si dhe mundësinë e njohjes së rregullave për transferimin e lojtarëve. Materiali i FIFA Clearing House do

të jetë shumë shpejt në duart e klubeve kosovare, në mënyrë që ta kenë sa më të qartë transferimin e lojtarëve, pasi që Kosova tanimë ka hyrë në agjendat e klubeve të Evropës për t'i transferuar talentet nga futbollit i Kosovës dhe kjo i ndihmon klubet e Kosovës që të jenë sa më të përgatitura për këto transferime, qoftë edhe për të marrë futbollistë nga jashtë. Kjo lidhet edhe me rregullat e të drejtës, ku për këtë temë kreu i FFK-së bisedoi me Daniel Cravo Souza, gjyqtar i Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv (CAS) dhe njohës i mirë i kësaj çështje dhe i akteve normative, në mënyrë që të bëhet një harmonizim i të gjitha konfederatave dhe federatave për të

pasur ligje, rregullore dhe statute të unifikuara, siç e ka FIFA të harmonizuar me Konfederatat e saj anëtare.

Cravo është edhe njohës i mirë i drejtësisë dhe ligjeve të shteteve, të cilat shpeshherë bien ndesh me statutet e federatave, raste këto që dëmtojnë sportin (me këtë rast futbollin) e tyre. Cravo tha se ekziston limiti ku ka diferenca nga ligji i FIFA-s me ligjet shtetërore. Ai ka thënë se duhet të ketë harmonizim për aq sa nuk ndërhyhet në statutin e FIFA-s dhe konfederatave anëtare. Presidenti Ademi dhe Daniel Cravo Souza u pajtuan që në kohën kur e shoh të nevojshme FFK-ja, ai të vijë dhe të mbajë seminar me klubet e Kosovës.

SHKURT

KB Peja përforcohet me amerikanin Vaughn

Pejë, 1 shkurt - KB Peja është përforcuar me amerikanin Kwame Vaughn. Basketbollisti në fjalë ka bërë karrierë në Gjermani, Francë e disa vende të tjera, por ka përvojë edhe në basketbollin e Kosovës. Ai ishte pjesë e KB Prizreni. "KB Peja ka arritur marrëveshje me basketbollistin amerikan të pozitës 1, Kwame Vaughn. Kwame do t'i bashkohet kampit verdhë e zi shumë shpejt, për të qenë forcë shtesë në rrugën për të gjitha trofetë. Vaughn ka ndërtuar karrierë në elita të mëdha të basketbollit evropian si Belgjikë, Francë, Gjermani, Kroaci, Rumani dhe në Kosovë. Më parë ka luajtur te KB Prizreni. Së fundmi ai ishte shënuesi dhe asistuesi më i mirë tek Astana në VTB League", thuhet në njoftimin e skuadrës pejane.

Kumbulla paraqitet te Sassuolo

Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Marash Kumbulla, është paraqitur në skuadrën e re, Sassuolo. Mbrojtësi Kumbulla nga AS Roma ka kaluar në skuadrën tjetër italiane në formë huazimi. Mbrojtësi shqiptar ka qenë i lidhur edhe me një kalim tek Udinese dhe Genoa. Kumbulla ka vuajtur shumë në sezonin e fundit, pasi ka qenë jashtë fushave nga sezoni i kaluar shkaku i një dëmtimi.

Jashari debuton me gol në LNZ Cherkasy

Muharrem Jashari e ka nisur me këmbë të mbarë përvojën në ekipin e ri. Futbollisti i deridjeshëm i Dritës ka shënuar gol në miqësoren e LNZ Cherkasy ndaj ekipit polak, Zaglembe. Jashari realizoi në barazimin 1-1, njoftoi klubi ukrainas përmes faqes së vet zyrtare. Pasi shkëlqeu në futbollin e Kosovës, mesfushori kualitativ synon t'i shfaqë vlerat e tij edhe në Ukrainë.

Fitorja e dytë radhazi për Bashkimin

KBF Bashkimi ka arritur fitoren e dytë radhazi në Ligën Unike Femrat, duke mundur Partizanin në udhëtim me rezultat 63:87 (12:15, 19:25, 14:21, 18:21). Prizrenaset e nisën ndeshjen më mirë me një seri prej 2:10, por vendaset u rikthyen shpejt. Çereku i parë përfundoi 12:15. Tiranaset arritën të kalojnë në epërsi 20:18, më pas u zhvillua lojë e barabartë, por në fund të pjesës së parë kampionet e Kosovës u shkëputën, duke shkuar në pushim me rezultat 31:40. Mysafiret vazhduan me lojë të mirë në pjesën e dytë. Ato ishin më të mira dhe triumfuan në fund 63:87. Sophia Jacobsson ishte më e mira te vendaset me 15 pikë, kurse Adrienne Godbolo me 24 pikë, 15 kërcime e pesë asistime dhe Sarah Mgbeike me 29 pikë, nëntë kërcime dhe tri asistime u dalluan te mysafiret. Për Partizanin ishte humbja e dytë në dy ndeshje, kurse fitorja e dytë për Bashkimin në dy ndeshje.

Elshani: Vëllaznimit do ta kthejmë në majat e futbollit

GJAKOVË, 1 SHKURT - Qemail Elshani është futbollist i ri i skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova. Mesfushori nga Drenasi vendosi të largohet nga Suahreka dhe të bëhet pjesë e klubit kuqezi. Pas këtij transferimi, Elshani ka thënë se organizimi i mirë ka bërë që ai ta pranojë ofertën e Vëllaznimit. "Duke parë një superorganizim

nga një kryesi korrekte e shumë punëtore, ju njoftoj se kam arritur marrëveshje me njërin nga skuadrat më të mëdha dhe më me traditë në futbollin e Kosovës, KF Vëllaznimi. Bashkë do të punojmë fort që Vëllaznimit ta kthejmë në majat e futbollit të Kosovës ashtu siç i ka hije", ka thënë Elshani, i cili e ka falënderuar

edhe ish-klubin që luajti në sezonin vjeshtor, Suharekën. "Dua të falënderoj kryesinë e FC Suhareka për këta muaj të kaluar së bashku dhe që me marrëveshje të dyanshme kemi shkëputur kontratën. Klubit i dëshiroj shumë suksese e mbarësi në vazhdim të kampionatit!", ka deklaruar Elshani.



Hamiltoni do të largohet nga Mercedesi, do t'i bashkohet Ferrarit

LONDËR, 1 SHKURT - Piloti britanik Lewis Hamilton do të largohet nga Mercedesi dhe do t'i bashkohet Ferrarit për sezonin 2025 në Formula 1. Kontrata aktuale e Hamiltonit me Mercedesin do të skadojë vitin e ardhshëm, por ai do të largohet nga ekipi pas këtij

sezoni dhe do ta zëvendësojë Carlos Sainz në Ferrari. Shtatë herë kampioni i botës është piloti më i suksesshëm në historinë e Formula 1 me 103 fitore dhe 104 pole position. Sezoni i ri fillon me Çmimin e Madh të Bahreinit nga 28 shkurti deri më 2 mars.

Hamiltoni, i cili nuk ka fituar asnjë garë që nga dhjetori 2021, iu bashkua Mercedesit në vitin 2013 nga McLaren dhe ka fituar gjashtë tituj botërorë me ekipin. Ai ishte i lidhur me Ferrarin për këtë vit, por nënshkroi një kontratë të re dyvjeçare verën e kaluar, së

bashku me shokun e skuadrës së Mercedesit, George Russell, për të qëndruar deri në fund të vitit 2025. "Sky Sports News" kupton se punonjësit e Mercedesit në Brackley do të njoftohen për lajmet sot përpara një njoftimi zyrtar.



Duka: Jemi të interesuar për ta vazhduar bashkëpunimin me Sylvinhon

TIRANË, 1 SHKURT - Presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit (FShF), Armand Duka, ka folur për Kombëtaren e Shqipërisë si dhe për të ardhmen e trajnerit Sylvinho. Thuhet se trajneri brazilian ka kontratë me FShF-në deri në përfundim të "Euro 2024". Dhe, sipas Dukës, palët mund të ulen para Kampionatit Evropian për të diskutuar për kushtet e reja. "Unë uroj që Sylvinho, i gjithë ekipi dhe të gjithë ne të bëjmë mirë në Evropian. Padyshim ta shijojnë Evropianin, Sylvinho kryesisht bashkë me ekipin, sepse është suksesi i tyre, janë ata që na kanë bërë ne krenarë dhe që jemi pjesë e këtij kompeticioni shumë të rëndësishëm", ka thënë fillimisht Duka për "Euronews Albania". "Pastaj padyshim ose më përpara do të duhet të diskutojmë për vazhdimin e bashkëpunimit të FShF-së me Sylvinhon dhe stafin e tij. Si gjithë opinionin dhe ne jemi pozitiv për vazhdimin e bashkëpunimit dhe vetë stafi dhe trajneri po ashtu, por më besoni që realisht gjatë gjithë muajit janar nuk jemi takuar, sepse lëvizjet kanë qenë vërtetë të mëdha, qoftë tonat,



të stafit kryesisht për organizimin dhe problemet e përgatitjeve në Evropian", ka deklaruar Duka. Përsa i përket shortit të "Euro 2024", ku kuqezinjtë u pozicionuan në të njëjtin grup me Kroacinë, Italinë dhe Spanjën, Duka ka thënë se në një garë të tillë "shkohet për të matur forcat", ndaj kundërshtarët e fortë janë gjithmonë aty. "Entuziazmi im ishte për faktin që jemi pjesë e një gare shumë të rëndësishme. Vërtetë ekipi na bëri të ndihemi krenar dhe entuziazmi lidhet me faktin që të gjitha ekipet në Evropian janë të nivelit të lartë".

"Por, në fund të fundit shkohet në një garë të rëndësishme për të matur forcat, për të sfiduar dhe për të takuar ekipe të mëdha. Zakonisht ekipet e mëdha i takon në gjysmëfinale në finale, ne kemi pasur fatin që t'i kemi në grup dhe pse jo të mos tentojmë për të bërë mirë, për t'i sfiduar dhe për të shkruar më tej", ka deklaruar Duka. "Të luash kundër Kampionëve të Evropës dhe Botës është kënaqësi, pikërisht për këtë dhe faktin që jemi në Evropian kam qenë entuziast", ka përfunduar i pari i FShF-së.

Zhgënjejnë ekipet 'big' në NBA



OKLAHOMA, 1 JANAR - Kampionët e Denverit u mundën me rezultat 105-100 në fushën e Oklahomas, skuadra surprizë e këtij sezoni në NBA. Mungesa e Donqiqit u ndje te Denveri, ndërsa Shai realizoi 34 pikë për vendasit. Humbet edhe

skuadra e Milwaukee, që u mund me rezultat 119-116 nga Portlandi. Simonsi me 24 pikë ishte shënuesi më i mirë për vendasit. Fitoi edhe Miami, që mundi Sacramento (115-106), ndeshje ku u dallua Butleri, autor

i 31 pikëve. Minnesota mbron vendin e parë në Perëndim, duke mundur thellë me rezultat 121-87 Dallasin. Ndeshje pa histori, ku u dallua Townsi, autor i 29 pikëve. Pa problem fitoi edhe ekipi i Phoenixit, që falë 33 pikëve të Durantit, mundi me rezultat 136-120 Brooklynin.

REZULTATET

Charlotte - Chicago	110-117
Cleveland - Detroit	128-121
Washington - Clippers	109-125
Miami - Sacramento	115-106
Houston - New Orleans	99-110
Minnesota - Dallas	121-87
Oklahoma - Denver	105-100
San Antonio - Orlando	98-108
Brooklyn - Phoenix	120-136
Portland - Milwaukee	119-116

SHKURT

Enver Idrizi emërohet drejtor i reprezentacionit të Kosovës në karate

Federata e Karatesë e Kosovës ka marrë vendim që legjenda e karatesë, Enver Idrizi, të jetë drejtor i reprezentacionit të Kosovës. Ky vendim është marrë në mbledhjen e parë konstituive të kësaj federate pas Kuvendit të Jashtëzakonshëm Zgjedhor të ftuar nga kryetari i FKK-së, Besart Baruti. "Enver Idrizi, legjenda jonë e karatesë, u emërua drejtor i reprezentacionit të Kosovës në karate", thuhet në njoftimin e FKK-së. Idrizi është një ish-karateist kroat dhe ish-kampion bote. Është shqiptar etnik, i lindur në Shkup. Ai ishte kampion i karatesë i Jugosllavisë në moshën 16-vjeçare.

Guardiola: Pesë skuadra janë në garë për titull

Pas katër fitore radhazi në Premierë Ligë, Manchester City është rikthyer në garën për titullin e kampionit në Premierë Ligë. Trajneri spanjoll, Pep Guardiola, pas fitores 3-1 ndaj Burnleyt, ka thënë se gara për titull nuk është në mes të tri ekipeve: Liverpool, Manchester City dhe Arsenal, por në këtë garë janë plotë pesë skuadra. "Jo, unë mendoj se janë më shumë se tri ekipe në garë. Tottenhami është aty, Aston Villa po ashtu. Nuk mund t'i ndaj. E rëndësishme është që ne jemi aty", u shpreh Guardiola.

Bonucci heq dorë nga padia ndaj Joves

Leonardo Bonucci ka hequr dorë nga padia ndaj Juventusit në lidhje me largimin e tij nga skuadra e bardhezinjve verën e kaluar. Kjo bëri që ai ta veshë fillimisht fanellën e Union Berlinit në Gjermani, më pas ka firmosur për Fenerbahcen në Turqi. Vendimi është bërë i ditur së fundmi nga klubi torinez. "Leonardo Bonucci ka hequr dorë nga ankesa e arbitrazhit kundër Juventusit, të cilët ne kemi pranuar gjithashtu të heqim dorë, me tejkalimin përfundimtar të mosmarrëveshjes, e cila ndodh pa asnjë pasojë financiare. Juventus dhe Bonucci ndajnë me kënaqësi të plotë mbylljen e kësaj afere duke lënë të paprekur rrugën dhe marrëdhënien fituese të ndërtuar ndër vite", shkruan klubi bardhezi.

Arsenali në verë synon transferimin e Rashfordit

Skuadra e Arsenalit thuhet se është e interesuar për nënshkrimin e yllit të Manchester Unitedit, Marcus Rashford. Javën e kaluar Rashfordi përfundoi në titujt e medieve pasi u raportua se humbi stërvitjen se ishte sëmurë por, në fakt, ai kishte qenë tepër i dehur pasi kishte konsumuar alkool në një bar gjithë natën. Ai u la jashtë skuadrës për ndeshjen e FA Cup dhe trajneri Ten Hag nuk foli shumë për këtë çështje, duke theksuar se është një çështje e brendshme dhe do të trajtohej me dyer të mbyllura. Tani flitet se Arsenali mund të përfitojë nga kjo situatë e ndërlikuar tek Unitedi dhe synon ta transferojë anglezin në merkaton e verës.

Anulohet gara e Çmimit të Madh të Argjentinës në MotoGP

Në prag të nisjes së provave të para dimërore të vitit 2024 në MotoGP (në Malajzi), ka ardhur lajmi i papritur: Botërori ka humbur një garë në kalendarin e tij për këtë sezon. Bëhet fjalë për garën e

Çmimit të Madh të Argjentinës, që do të dalë nga kalendarin. FIM, IRTA dhe Dorna Sports konfirmojnë anulimin e garës së Amerikës së Jugut, e cila ishte planifikuar për fundjavën e parë të prillit (nga e

premtja 5 deri të dielën 7). Për shkak të rrethanave aktuale në Argjentinë, promovuesi i garës ka komunikuar se aktualisht nuk është në gjendje t'i garantojë shërbimet e kërkuara për të

mbajtur Grand Prix më 2024 sipas standardeve të MotoGP. I planifikuar fillimisht si raundi i tretë i sezonit, pas Katarit e Portugalisë dhe menjëherë para Austin, gara e Argjentinës (e fituar

vjet nga Marco Bezzecchi) nuk do të zëvendësohet me asnjë pistë tjetër në kalendarin e 2024-s. Për këtë arsye, Botërori 2024 në MotoGP do të jetë me 21 gara në total.



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Administrator/e i/e Sistemeve (zyrtar i ri)
Grada e pozitës: shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit: pa afat
Pozita: e përhershme
Departamenti: Teknologjia Informative
Divizioni: Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Raporton tek: Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Përmbledhja e punës:

Administrator/e i/e Sistemeve (zyrtar i ri), është përgjegjës për instalimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e të gjitha sistemeve serverike të Microsoft Windows Server.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Instalon, konfiguroni dhe zgjidh problemet me sistemet ekzistues dhe të reja të Microsoft Windows Serverëve dhe roleve të tyre.
- Instalon, konfiguroni dhe zgjidh problemet duke përfshirë: Server, Storage, SAN Switch dhe pajisje tjera në kuadër të Departamentit të Teknologjisë Informative.
- Instalon, konfiguroni, mirëmban dhe zgjidh problemet në infrastrukturën fizike dhe virtuale.
- Instalon konfiguroni dhe mirëmban sistemet me role të caktuara siç janë, Active Directory, Failover Cluster, Hyper-V, File Server, DNS Server, DHCP Server, Exchange Server, Web Server, PKI Server, Print Server etj.
- Ndërmerr veprime për të siguruar integritetin dhe sigurinë e të dhënave.
- Ndërmerr veprimeve për të përmirësuar efikasitetin dhe performancën e infrastrukturës së sistemeve.
- Ofron ndihmë teknike për përdoruesit e sistemit në lidhje me problemet e tyre të teknologjisë.
- Zhvillon dhe zbaton strategji për backup dhe rikuperim të të dhënave.
- Siguron që të dhënat janë të mbrojtura dhe të rikuperueshme në rast të ndonjë problemi.
- Zbaton politikat dhe procedurat e sigurisë dhe administrimit të sistemeve.
- Bashkëpunon me ekipet tjera të IT-së për zgjidhjen e çështjeve komplekse.
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Ndjekë zhvillimet e teknologjisë dhe përmirëson njohuritë dhe aftësitë personale përmes trajnimeve dhe certifikimeve.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI-së.
- Mirëmban dokumentimin e konfigurimeve të sistemeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative

Edukimi:

- Shkallë bachelor në shkenca kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e Administratorit të sistemeve të TI-së të bazuara në Microsoft.

Përvoja e punës:

- Përvojë e preferuar së paku 1 vjeçare në administrim të sistemeve në Windows Server 2016, 2019, 2022 dhe rolet e tyre.
- Njohuri në menaxhim të DC, DNS, DHCP, PKI, Hyper-V, e preferuar
- Përvojë në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI, e preferuar.
- Përvojë në infrastrukturën e IT-së në mjedisin e “Cloud Computing”, e preferuar.
- Gjuha angleze, e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare : www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Administrator/ka sistema (novi službenik)
Stepen položaja: Sedam (7)
Trajanje zapošljavanja: Rad na neodređeno vreme
Položaj: Stalni
Odeljenje: Informacione tehnologije
Odsek: Informacione tehnologije i sistemi
Izveštava: Šefu Odeljenja za informacione tehnologije i sisteme

Rezime radnog mesta:

Administrator/ka sistema (novi službenik) je odgovoran/na za instalaciju, održavanje i administraciju svih Microsoft Windows Server serverskih sistema.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

- Instalira, konfigurise i rešava postojeće i nove Microsoft Windows Server sisteme i njihove uloge.
- Instalira, konfigurise i rešava probleme uključujući: Server, Storage, SAN Switch i druge uređaje u okviru Odeljenja za informacione tehnologije.
- Instalira, konfigurise, održava i rešava fizičku i virtualnu infrastrukturu.
- Instalira, konfigurise i održava sisteme sa određenim ulogama kao što je Active Directory, Failover Cluster, Hyper -V, File Server, DNS Server, DHCP Server, Exchange Server, Web Server, PKI Server, Print Server itd.
- Preduzme mere kako bi obezbedio integritet i bezbednost podataka.
- Preduzme mere za poboljšanje delotvornosti i učinka infrastrukture sistema.
- Pružna tehničku pomoć korisnicima sistema u vezi sa njihovim tehnološkim problemima.
- Razvija i primenjuje strategije za bekap i obnavljanje podataka.
- Osigurava da podaci budu zaštićeni i obnovljivi u slučaju bilo kakvog problema.
- Primenjuje politike i postupke za bezbednost i administraciju sistema.
- Sarađuje sa drugim IT timovima na rešavanju složenih problema.
- Održava licence i komunicira sa eksternim pružiocima usluga.
- Prati razvoj tehnologije i poboljšava lična znanja i veštine kroz obuku i sertifikaciju.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Održava dokumentaciju konfiguracija sistema, kreira postupke i priručnike za celu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Ostale poslove koji se određuju od strane odgovornih osoba po hijerarhiji Odeljenja za informacione tehnologije.

Obrazovanje:

- Diploma iz bachelor studija iz računarskih nauka ili odgovarajući sertifikat relevantni za ulogu administratora IT sistema bazirani na Microsoft.

Radno iskustvo:

- Poželjno je najmanje 1 godina iskustva u administraciji sistema u Windows Server 2016, 2019, 2022 i njihovim ulogama.
- Poznavanje upravljanja u DC, DNS, DHCP, PKI, Hyper -V, poželjno,
- Iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture, poželjno,
- Iskustvo u IT infrastrukturi u okruženju „Cloud Computing”, poželjno.
- Engleski jezik, poželjno.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Rok za prijavu je **16. februar 2024. godine**.
- Prijava se može vršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org



RISHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Analist i sigurisë kibernetike (Zyrtar i lartë)
Niveli i gradës: pesë (5)
Kohëzgjatja e punësimit: pa afat
Pozita: e përhershme
Departamenti: Teknologjia Informative dhe Sigurisë
Divizioni: i Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë
Raporton tek: Udhëheqësit të Divizionit të Sigurisë Kibernetike dhe Vazhdimësisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Konfiguron sistemet dhe veglat e sigurisë se informacionit, i mirëmban dhe sigurohet që të funksionojnë sipas kërkesave, duke përfshirë sistemet për mbledhje të log-ëve, skanime të sigurisë për dobësi dhe sistemet e tjera të sigurisë se informacionit.
- Monitoron rrjetin kompjuterik për çështjet e sigurisë.
- Monitoron, analizon dhe raporton alarmet e sigurisë, incidentet, raportet mbi dobësitë që mbliiden nga disa burime, si: SIEM, sisteme të tjera të monitorimit, skanime të dobësive, etj.
- Rishikon, hulumton dhe raporton alarmet e dobësive, duke ofruar:
 - analizën relevante të tyre,
 - propozon përmirësimet e nevojshme dhe përcjellë përmirësimet e propozuara,
 - menaxhon skanimet e planifikuara, identifikon zbrazëtitë në to dhe zgjeron fushën e skanimeve sipas nevojës, si dhe përshkallëzon alarmet e sigurisë sipas nevojës.
- Hulumton shkeljet e sigurisë dhe incidentet tjera të sigurisë kibernetike.
- Dokumenton shkeljet e sigurisë dhe vlerëson dëmin që ato shkaktojnë.
- Punon me ekipin e sigurisë për të kryer teste dhe për të zbuluar dobësitë e rrjetit.
- Rregullon dobësitë e zbuluara për të ruajtur një standard të lartë të sigurisë.
- Zhvillon praktikatat më të mira në BQK për sigurinë e informacionit.
- Ndihmon në përgatitjen dhe implementimin e programit të vetëdijesimit të shfrytëzuesve të BQK-së për praktikatat më të mira të sigurisë së informacionit dhe politikatat e DVPSI.
- Mbështet iniciativat e propozuara të sigurisë së informacionit që të siguroj suksesin e tyre.
- Kërkon përmirësime të sigurisë dhe bën rekomandime për menaxhmentin.
- Qëndron i azhurnuar në lidhje me avancimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe standardet e sigurisë.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit

Edukimi:

Shkallë universitare (bachelor) nga një institucion i akredituar në Kosovë në fushën e Shkencave Kompjuterike ose certifikime relevante në fushën e sigurisë së informacionit (p.sh. CEH, CCNA Security, Microsoft MTA Security, CompTia Security+, CompTIA CySA+ dhe certifikime tjera ndërkombëtare te fushës së sigurisë së informacionit).

Përvoja e punës:

Së paku tre (3) vite përvoja në fushë e sigurisë së informacionit.

Njohja e gjuhëve te huaja:

Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org.



PONOVNO OGLAŠAVANJE RADNOG MESTA

Naziv radnog mesta: Analitičar kibernetičke bezbednosti (viši službenik)
Nivo stepena: Pet (5)
Trajanje zapošljavanja: Rad na neodređeno vreme
Položaj: Stalni
Odeljenje: Informacione tehnologije i bezbednost
Odsek: Kibernetičke bezbednosti i kontinuiteta
Izveštava: Šefu Odseka za kibernetičku bezbednost i kontinuitet

Dužnosti i odgovornosti:

- Konfiguriše, održava i osigurava da sistemi i alati za informacijsku bezbednost rade prema zahtevima, uključujući sisteme za prikupljanje logova, skeniranje bezbednosti za ranjivost i ostale sisteme za bezbednost informacija.
- Prati računarsku mrežu zbog bezbednosnih problema.
- Prati, analizira i prijavljuje bezbednosna upozorenja, incidente, izveštaje o ranjivosti koji se prikupljaju iz više izvora, kao što su: SIEM, ostali sistemi za praćenje, skeniranje ranjivosti itd.
- Pregleda, istražuje i prijavljuje upozorenja o ranjivosti, pružajući:
 - njihovu odgovarajuću analizu,
 - predlaganja potrebna za poboljšanje i prati predložena poboljšanja,
 - upravljanje planiranim skeniranjima, identifikuje nedostatke u njima i proširuje opseg skeniranja po potrebi i graduira upozorenja o bezbednosti po potrebi.
- Istražuje kršenja bezbednosti i druge incidente kibernetičke bezbednosti.
- Dokumentira kršenja bezbednosti i procenjuje štetu koju oni uzrokuju.
- Radi sa timom za obezbeđenje na izvođenju testova i otkrivanju ranjivosti mreže.
- Popravlja otkrivene ranjivosti kako bi održao visok standard bezbednosti.
- Razvija najbolje prakse u CBK-u za bezbednost informacija.
- Pomaže u pripremi i realizaciju programa CBK-a za podizanje svesti korisnika o najboljim praksama bezbednosti informacija i politikama OKRBI-a.
- Podržava predložene inicijative za bezbednost informacija kako bi se osigurao njihov uspeh.
- Zahteva poboljšanja u bezbednosti i daje preporuke upravi.
- Ostaje u toku sa novinama u informatičkoj tehnologiji i bezbednosnim standardima.
- Obavlja i druge poslove po zahtevu šefa.
- Qëndron i azhurnuar në lidhje me avancimet në fushën e teknologjisë së informacionit dhe standardet e sigurisë.
- Kryen detyra të tjera sipas kërkesës së udhëheqësit

Edukimi:

Shkallë universitare (bachelor) nga një institucion i akredituar në Kosovë në fushën e Shkencave Kompjuterike ose certifikime relevante në fushën e sigurisë së informacionit (p.sh. CEH, CCNA Security, Microsoft MTA Security, CompTia Security+, CompTIA CySA+ dhe certifikime tjera ndërkombëtare te fushës së sigurisë së informacionit).

Përvoja e punës:

Së paku tre (3) vite përvoja në fushë e sigurisë së informacionit.

Njohja e gjuhëve te huaja:

Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org.



SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës:	Administrator/e i/e Rrjetit (zyrtar i ri)
Grada e pozitës:	shtatë (7)
Kohëzgjatja e punësimit:	pa afat
Pozita:	e përhershme
Departamenti:	Teknologjia Informative
Divizioni:	Teknologjisë Informative dhe Sistemeve
Raporton tek:	Udhëheqësi i Divizionit të Teknologjisë Informative dhe Sistemeve

Administratori i Rrjetit është përgjegjës për administrimin, përmirësimin dhe avancimin e infrastrukturës së rrjetave të teknologjisë informative. Gjithashtu është përgjegjës për sigurinë e informacionit në infrastrukturën e rrjetit.

Përgjegjësitë dhe detyrat e punës:

- Instalon, konfiguroni, administron dhe mirëmban të gjitha komponentët e rrjetave (Router, Firewall, Switch) që janë pjesë e infrastrukturës së TI-së në BQK.
- Konfiguroni dhe mirëmban ndërlidhjet (VPN) me institucionet tjera.
- Analizon kërkesat për ndryshim ose shtim të funksioneve në rrjetin e BQK-së dhe ofron zgjidhje adekuat.
- Bashkëpunon ngusht me administratorët dhe teknikët brenda divizionit dhe me zyrtarët e divizioneve tjera.
- Trajton gjetjet nga monitorimet dhe raportet e sigurisë së informacionit.
- Shërben si nivel i dytë i trajtimit të incidenteve dhe problemeve tek të gjithë shfrytëzuesit e teknologjisë informative.
- Zgjidh problemet që raportohen nga shfrytëzuesit e brendshëm dhe të jashtëm të rrjetit të BQK.
- Monitoron dhe bën matje të performancës së komponentëve të rrjetave, duke përfshirë pajisjet e BQK-së në shfrytëzim nga shfrytëzuesit e jashtëm.
- Mirëmban licencat dhe komunikon me ofruesit e shërbimeve të jashtme.
- Planifikon dhe ofron zgjidhje bazuar në matjet e komponentëve për të siguruar vazhdimësinë dhe sigurinë e shërbimeve të rrjetit.
- Mirëmban dokumentim të konfigurimeve, krijon procedura dhe manuale për të gjitha pajisjet dhe shërbimet për të cilat është përgjegjës.
- Merr pjesë aktive në përgatitjet dhe planifikimet afatshkurta dhe afatgjata të TI-së.
- Aplikon udhëzimet dhe standardet e sigurisë.
- Detyra tjera që i caktohen nga përgjegjësit në hierarkinë e Departamentit të Teknologjisë Informative dhe Sigurisë

Kualifikimet dhe përvoja:

- Shkallë bachelor në shkencat kompjuterike ose certifikime përkatëse që lidhen me rolin e administratorit të rrjetit.
- Përvojë e preferuar, së paku 1 vjeçare në administrim të rrjetave.
- Përvoja në ambiente komplekse të infrastrukturës së TI e preferuar.
- Njohuri në menaxhim të firewall-ëve
- Gjuha angleze e preferuar.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **16 shkurt 2024**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org



OGLAS ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta:	Administrator/ka mreže (novi službenik)
Stepen položaja:	Sedam (7)
Trajanje zapošljavanja:	Rad na neodređeno vreme
Položaj:	Stalni
Odeljenje:	Informacione tehnologije
Odsek:	Informacione tehnologije i sistemi
Izveštava:	Šefu Odeljenja za informacione tehnologije i sisteme

Administrator/ka mreže je odgovoran/na za administraciju, poboljšanje i unapređenje infrastrukture mreže informacionih tehnologija. Takođe je odgovoran/na za bezbednost informacija u infrastrukturi mreže.

Radne dužnosti i odgovornosti:

- Instalira, konfiguriše, administrira i održava sve komponente mreže (Router, Firewall, Switch) koje su deo IT infrastrukture u CBK-u.
- Konfiguriše i održava interkonekcije (VPN) sa drugim institucijama.
- Analizira zahteve za promenu ili dodavanje funkcija u mreži CBK-a i nudi adekvatna rešenja.
- Blisko sarađuje sa administratorima i tehničarima unutar odseka kao i sa službenicima iz drugih odseka.
- Obraduje nalaze praćenja i izveštaja o bezbednosti informacija.
- Služi kao drugi nivo rešavanja incidenata i problema za sve korisnike informacionih tehnologija.
- Rešava probleme prijavljeni od strane internih i eksternih korisnika mreže CBK-a.
- Prati i meri učinak komponentata mreže, uključujući opremu CBK koju koriste spoljni korisnici.
- Održava licence i komunicira sa eksternim pružaočima usluga.
- Planira i daje rešenja zasnovana na merenja komponenti kako bi se osigurao kontinuitet i bezbednost mrežnih usluga.
- Održava dokumentaciju vezano za konfiguraciju, kreira postupke i priručnike za celu opremu i usluge za koje je odgovoran.
- Aktivno učestvuje u kratkoročnim i dugoročnim IT pripremama i planiranju.
- Primenjuje uputstva i standarde bezbednosti.
- Ostale poslove koji se određuju od strane odgovornih osoba po hijerarhiji Odeljenja za informacione tehnologije.

Kvalifikacije i iskustvo:

- Diploma iz bachelor studija u računarskim naukama ili odgovarajući sertifikati relevantni za ulogu administratora mreže.
- Poželjno iskustvo, najmanje 1 godina u administraciji mreže.
- Poželjno iskustvo u složenim okruženjima IT infrastrukture.
- Poznavanje upravljanja firewall-a
- Engleski jezik, poželjno.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Službeni obrazac CBK-a za prijavu;
- Propratno (motivaciono) pismo u kojem je naglašen interes za ovaj položaj;
- Kopije diploma, a diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje državljanstva Kosova.

Postupak prijave:

- Rok za prijavu je **16. februar 2024. godine**.
- Prijava se može vršiti i putem interneta (<https://hris.bqk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko službene internet stranice: www.bqk-kos.org

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Eda” SH.P.K. me seli në Gjilan, me pronar Shqiprim Vokshi, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811187740 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Eda” D.O.O. Gnjlane, sa vllasnikom Shqiprim Vokshi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811187740 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Eda” L.L.C. with headquarters Gjilan, with owner Shqiprim Vokshi, has come to the decision to quit its business: 811187740 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Në mbështetje të Nemit 40 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Kuvendi i Shoqërisë Kullat e Latës Sh.P.K. në mbledhjen e datës 24.12.2023 nxjerrë këtë:

V E N D I M
Për zbritje të kapitalit

I. Miratohet zvogëlimi i kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, ashtu që kapitali i përgjithshëm i shoqërisë tregtare Kullat e Latës Sh.P.K. do të jetë:

Kapitali i shoqërisë do të jetë 399,500.00 € (me fjalë: treqind e nëntëdhjetë e nëntëmijë e pesëqind euro), ku numri i aksioneve është 100 me vlerë nominale prej 3,995.00 € për aksion. Lloji i aksioneve: të thjeshta.

Pjesëmarrës në aksione të shoqërisë do të jenë aksionarët sipas pjesëmarrjes në përqindjen e aksioneve të kapitalit të zvogëluar të përgjithshëm si në vijim:

Ardiana Hasani - Mitrovicë, Rr.Avni Shabani B/5, Mitrovicë, pjesa në pronësi 57727.75 € apo në përqindje prej 14.45% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

Sadije Jashari - Prishtinë, Dardani Rr-Idriz Gjilani kurriz hy 8/7, Prishtinë, pjesa në pronësi 57727.75 € apo në përqindje prej 14,45% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

Arben Jashari - Mitrovicë, Sheshi Agim Hajrizi Nr 45/4/12,40000, Mitrovicë, pjesa në pronësi 284084.45 € apo në përqindje prej 71,11% të aksioneve të shoqërisë - Aksionar

II. Shtimi i kapitalit siç është përkufizuar me paragrafin I të këtij Vendimi, do të jet i përfshirë në Statutin e shoqërisë në procedurën e ndryshimeve të shoqërisë sipas procedurave përkatëse.

III. Ky vendim hyjn menjëherë.

Mitrovicë, me datë 25 dhjetor 2023

Aksionarët
Arben Jashari
Sadije Jashari
Ardiana Hasani
A Hasani



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Egzon Berisha shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Elvis Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K “11 Marsi” Prizren.

- Andi Gashi shpall te pavlefshme dëftesat, diplomën Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Valon Dula nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M “Hysni Zajmi”, drejtimi Teknik i Teknologjisë.

- Musa Hashani shpall te pavlefshme 4 dëftesa, diplomën , vërtetimin për gjendjen e notave dhe mungesave Q.K. “11 Marsi” Prizren.

- Betul Kabash shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

- Memli Bala shpall te pavlefshme dëftesat e kl X,XI,XII, XIII shme “Ymer Prizreni” Prizren.

- Arbresha Hajra shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu “Mati Logoreci” Prizren.

- Përparen Krasniqi shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër 810055336 "155SHOES" SHPK

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049/44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

